



Regj.nr. 3421/2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË SUHAREKË, Gjyqtarja Lirije Kafexholli me Sek.juridike Belkize Gashi, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Vesel Maliqaj nga fsh. Dubravë, për kundërvajtjen e kryer nga neni 16 paragrafi I.I te Ligjit per deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve te lartë publik, si dhe në bazë të nenit 73,195,199 dhe 200 par.I të Ligjit mbi Kundërvajtjet me dt.19.04.2011 merrë këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Vesel Maliqaj nga fsh. Dubravë Komuna e Suharekës, ku dhe tani jeton, punon si Kryesues I Ansamblesë Komunale KK Suharekë, gjerë me tani kinse jo i denuar.

ËSHTË PËRGJEGJES

Sepse si Zyrtar I lartë publik nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë së tij per vitin 2009 deri me 31.03.2010 ne Agjencionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë.

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 16. paragrafi I.I te Ligjit per deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe te dhuratave te Zyrtarëve te Lartë Publik, e me aplikimin e të njejtit:

GJOBITET

Me gjobë në të holla në shumë prej 300 (Treqindë) EURO të cilën ka për ta paguar mbrenda 15 ditësh, pasi që ky Aktvendim të merrë formë të prerë në favor të Sekretariatit te Kshillit Gjyqësor të Kosoves me nr.gjirollogaris. 1000-4300-7000-0518 pagesa bëhet nëpër mes kesaj Gjykate, nëse nuk e paguan e njëjta do t i zavendesohet me denim burgimi prej 20 ditësh, duke i u llogaritur 15 (EURO) me një ditë burgimi

Shpenzimet e procedures kundërvajtëse - shumë paushalle prej 5 (Euro) është i obliguar që t i paguaj në afat prej 15 ditësh, prej kur ky aktvendim të merrë formë të prerë në favor të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Suharekë.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi t'i dërgohet parashtrusit të kërkesës dhe të pandehurit.

ARSYETIM

Me kërkesën e Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë me nr. 01/2257/10 te dt. 08.06.2010 është ngritur procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Vesel Maliqaj per kundërvajtjen e pershkruar si ne dispozitiv te keti aktvendimitt.

I pandehuri se me dt. 12.12.2010, 25.01.2011 dhe 04.04.2011 nuk i është përgjegjur ftesës së këtij gjyqtari, për të marrë pjesë në seancën kryesore dhe mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë, prandaj dhe aktvendimi është marrur pa marrjen në pyetje të të pandehurit në bazë të nenit 200 paragrafi 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, pasi që edhe në ftesë i është bërë me dije se nese nuk i përgjigjet ftesës, Aktvendimi do të merret pa e marrur në pyetje.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË SUHAREKË

Sek.juridike
Belkize Gashi



UDHËZIME JURIDIKE: Palet e paknaqur kundër këtij Aktvendimi, kanë të drejtë ankese Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej marrjes së të njëjtit, përmes të kësaj Gjykate.